

VENDIM
Nr. 82, datë 28.12.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese			
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“	
Sokol Berberi	anëtar i	“	“	
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“	
Gani Dizdari	anëtar i	“	“	
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“	
Fatos Lulo	anëtar i	“	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“	

me sekretare Edmira Babaj, në datën 29.10.2015 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 63 Akti që i përket:

KËRKUES: Armant Rrudha

SUBJEKT I INTERESUAR: Vjollca Mësonjësi

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 767/32 akti, datë 7.6.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. 43, datë 6.3.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2015-71, datë 20.1.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 33, 41, 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit Armant Rrudha, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, dhe pretendimet me shkrim të subjektit të interesuar Vjollca Mësonjësi, e cila ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi ka qenë palë e paditur në çështjen me objekt: *“Pjesëtim pasurie bashkëshortore, apartament banimi në Fier, tokë bujqësore në Dujakë dhe një mjet furgon “Benz Mercedes”...”,* e cila është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier. Kjo e fundit, me vendimin nr. 767/32 akti, datë 7.6.2011, ka vendosur: *“Pranimin e pjesës së kërkesëpadisë, lejimin e pjesëtimit të pasurisë së paluajtshme, duke përcaktuar palët ndërgjyqëse (ish-bashkëshortë) si bashkëpronarë në 1/2-ën pjesë ideale. Rrëzimin e pjesës tjetër të padisë...si të pabazuar në ligj e prova”*.

2. Mbi ankimin e kërkesit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 43, datë 6.3.2012, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të fazës së parë të pjesëtimit nr. ska, datë 7.6.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier”*.

3. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2015-71, datë 20.1.2015, ka vendosur, në dhomë këshillimi, mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuuesi.

II

4. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 14.4.2015 me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

4.1 Gjykatat e dy shkallëve të para kanë lejuar pjesëtimin e banesës edhe pse ish-bashkëshortja

nuk ka qenë bashkëpronare në atë pasuri.

4.2 Gjykata e Apelit Vlorë jo vetëm nuk ka respektuar kërkesat për njoftimin e palës ankimuese, por ka marrë një vendim, ku pasqyron fakte të manipuluar dhe në kundërshtim me ligjin.

4.3 Gjykata e Lartë jo vetëm e shqyrtoi çështjen pas tre vjetësh, nuk mori masa për njoftimin e kërkuarit mbi zhvillimin e procesit gjyqësor, por edhe vendimi gjyqësor qëllimisht iu njoftua me tre muaj vonesë.

5. **Subjekti i interesuar, Vjollca Mësonjësi**, ka prapësuar me shkrim si vijon:

5.1 Pretendimi për interpretimin e gabuar të ligjit material është i pabazuar, për faktin se interpretimi është detyrë funksionale e gjykatave të zakonshme dhe jo e juridiksionit kushtetues. Për sa kohë nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se pasuria objekt gjykimi është vendosur gjatë martesës, nuk ka vend që të merren në shqyrtim pretendimet e kërkuarit.

5.2 Pretendimi për cenimin e nenit 42 të Kushtetutës nuk është ngritur në nivel kushtetues.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Në lidhje me legjitimitimin e kërkuarit

6. Kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30, pika 2 e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

7. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se në përmbajtjen e kërkesës nuk evidentohet shprehimisht standardi kushtetues, që pretendohet nga kërkuari se mund të jetë cenuar gjatë proceseve gjyqësore. Bazuar në parimin *jura novit curia*, Gjykata rithekson qëndrimin se ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që u është bërë fakteve të çështjes nga kërkuari (*shih vendimet nr. 19, datë 25.4.2013; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjykata rithekson se ajo ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131, shkronja “P”, të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 16, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në vështirim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruara nga kërkuari duhet të trajtohen në këndvështrimin e garantimit të standardit kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe të së drejtës për akses në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, kërkuari legjitimohet *ratione materiae*.

B. Për cenimin e standardit kushtetues të arsytimit të vendimit dhe së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë

10. Kërkuari ka pretenduar se nuk ka pasur dijeni për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Vlorë. Ai parashtron në kërkesë se nuk është njoftuar lidhur me këtë proces, prandaj e ka ngritur këtë pretendim edhe në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, por kjo e fundit ka vendosur mospranimin e rekursit.

11. Gjykata rithekson se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në këtë

kuptim, ky standard përfshin të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit në gjykatë duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. Aksesit duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2013, nr. 14, datë 26.3.2012; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 7 datë 11.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 5, datë 6.3.2009; nr. 17, datë 18.7.2008; nr. 15, datë 17.4.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata ka theksuar se në funksion të garantimit të së drejtës së aksesit është e një rëndësie thelbësore edhe respektimi i standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 3, datë 23.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Po ashtu, Gjykata ka vlerësuar se bazuar në parashikimet e normave procedurale që përcaktojnë elementet që duhet të përmbajë një vendim gjyqësor, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimet nr. 36, datë 25.7.2013; nr. 2, datë 26.1.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në vështrim të standardeve të mësipërme dhe rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata vëren se referuar akteve që gjenden të administruara në dosjen gjyqësore, procesi gjyqësor në Gjykatën e Apelit Vlorë është vënë në lëvizje nëpërmjet ankimit të paraqitur nga i padituri (kërkuesi), kurse paditësja ka paraqitur apel kundërshtues. Gjyqtari i çështjes në vendimin e datës 17.2.2012 ka urdhëruar që *njoftimi i palëve ndërgjyqëse të bëhet me shpallje, konform nenit 460/3 të KPC-së, për ditën dhe orën e gjykimit të çështjes*. Nga procesverbali i seancës gjyqësore rezulton se kërkuesi nuk është paraqitur dhe gjykata ka vijuar me gjykimin në mungesë, duke arsyetuar se kërkuesi është vënë në dijeni me shpallje dhe pa shkaqe të arsyeshme nuk është paraqitur. Në këtë proces gjykata ka pranuar kërkesën e mbrojtësit ligjor të paditëses, dhe ka vendosur përsëritjen e pjesshme të hetimit gjyqësor, duke depozituar certifikatën e pronësisë dhe një shkresë të Ministrisë së Transporteve. Në përfundim të procesit, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

16. Kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, ku, midis të tjerash, ka pretenduar mosrespektimin e së drejtës së mbrojtjes, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si rezultat i mosnjoftimit për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Apelit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-71, datë 20.1.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit duke arsyetuar se *"...rekursi i paraqitur nga pala e paditur nuk përmban asnjërin prej rasteve të nenit 472 të KPC-së, për rrjedhojë nuk duhet pranuar"*.

17. Gjykata, duke iu referuar vendimit të Kolegjit Civil për mospranimin e rekursit, konstaton se në pjesën hyrëse ai përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë

dhe të apelit, si dhe faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit ka paraqitur rekurs kërkuesi. Po ashtu, Gjykata vëren se vendimi i Kolegjit Civil nuk pasqyron në pjesën hyrëse të gjitha shkaqet e parashtruara në rekurs nga kërkuesi, konkretisht pretendimin e tij në lidhje me mosnjohimin për zhvillimin e gjykimit në Gjykatën e Apelit.

18. Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se mosdhënia përgjigje nga Kolegji Civil mbi pretendimin kryesor të kërkuesit që lidhet me aksesin në gjykatë, i ka cenuar atij të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar në përputhje me nenin 142/2 të Kushtetutës dhe po ashtu të drejtën për akses efektiv në Gjykatën e Lartë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

19. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesit në lidhje me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “P”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2015-71, datë 20.1.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo